

Prishtinë, 29 janar 2007  
Kodi i ZRRE-së: D\_30\_2007

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Ka përcaktuar nevojën për një aranzhim të përkohshëm të pagesës së transmisionit që të aplikohet deri me hyrjen në fuqi të pagesave të reja për Shfrytëzimin e Sistemit të Transmisionit (TUOS) për vitin 2007.

### **Duke marrë parasysh:**

1. Që pagesat e reja të TUOS nuk do të hyjnë në fuqi deri me 19 shkurt 2007 ose më vonë, në përputhje me dispozitat e Rregullit për Parimet e Kalkulimit të Tarifave në Sektorin e Energjisë ('Rregulli për çmime') dhe datën e dorëzimit të pagesave të propozuara të TUOS dhe datës së dorëzimit të pagesave të propozuara për TUOS KOSTT SHA me 10 janar 2007.
2. Nevojën e rezultuar për të themeluar një aranzhim për pagesë të përkohshme që udhëheq pagesat nga KEK ShA tek KOSTT SHA për shfrytëzim të rrjetit të transmisionit dhe dispozitën e menaxhimit të sistemit dhe shërbimeve për operimet e tregut për tu aplikuar nga 1 janari 2007 deri në datën e hyrjes në fuqi të pagesave të TUOS.
3. Aranzhimi i mëparshëm i pagesës së përkohshme i lidhur në mes të KEK ShA dhe KOSTT Sha nën "Marrëveshjen për Marrëdhënie të Përkohshme Komerciale dhe Operacionale në mes të KEK ShA dhe KOSTT Sha", e cila ka përfunduar me 1 Janar 2007.

### **Në seancën e Bordit të mbajtur me 29 janar 2007, ka marrë vendim të:**

1. të kërkoj vazhdimin e aranzhimit të përkohshëm për pagesë të themeluar në mes të KEK ShA dhe KOSTT Sha sipas "Marrëveshjes për Marrëdhënie të Përkohshme Komerciale dhe Operacionale në mes të KEK ShA dhe KOSTT Sha", deri me hyrjen në fuqi të pagesave të TUOS.
2. Aprovoi që, në përputhje me këtë marrëveshje, KEK ShA do të paguaj, çdo muaj, shumën prej €510,000 tek KOSTT Sha për përdorim të rrjetit të transmisionit dhe furnizim të shërbimeve për menaxhim të sistemit dhe operim të tregut. Për periudha me kohëzgjatje më të vogël se një muaj të plotë, kjo shumë do të rregullohet pro-rata për pjesën e muajt që i nënshtrohet aranzhimit të përkohshëm për pagesë.



Bordi i ZRRE-së:

---

Nick Frydas, Kryesues,

---

Merita Kostari, anëtare,

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Nysret Avdiu, anëtar

---

Naim Bejtullahu, anëtar



## **Bashkangjitur: Aranzhimet e Përkohshme për Pagesë**

Sipas KEK ShA – KOSTT ShA “Marrëveshjes në Lidhje me Marrëdhëniet e Përkohshme Komerciale dhe Operacionale Ndërmjet KEK ShA dhe KOSTT ShA për Transferin e Përgjegjësisë për Operim dhe Mirëmbajtje të Rrjetit të Transmisionit të KOSTT ShA”, janë themeluar aranzhimet e përkohshme për pagesa për shfrytëzim të rrjetit të transmisionit të KOSTT ShA dhe shërbimeve të themeluara për operimin të tregut dhe të sistemit:

### **Neni 4. Tarifa e përkohshme e KOSTT-it**

- 4.1 Si rezultat i shërbimeve të mira të ZRRE-së pagesa e Tarifës së përkohshme nga KOST ShA tek KOSTT ShA është rënë dakord në bazat në vazhdim:
- 4.2 Buxheti operacional për vitin 2006 për Divizionet e Transmisionit dhe Dispeçingut është aprovuar nga Bordi i KEK ShA në vlerë prej €3.57 milion. Bilanci i kësaj shume të pashfrytëzuar nga KOSTT ShA me 30 qershor 2006 do të paguhet nga KEK ShA tek KOSTT ShA si Tarifë e Përkohshme në shtatë pjesë të barabarta duke filluar nga korriku 2006. Pagesa e parë do të paguhet me 1 korrik 2006 për të ofruar kapital të hapur për punë; pjesët e tjera të mbetura do të paguhet në ditën e pesëmbëdhjetë të muajt, pjesët e pagesës mujore do të nënshtrohen përshtatjes tremujore të përmbushjes së inkasimit të KEK-ut.
- 4.3 Propozimi për Tarifë të Përkohshme i dorëzuar në ZRRE, dhe vendimi i ZRRE-së i nxjerr si rezultat i kësaj janë të përfshira në Aneksin 7.
- 4.4 Rregullimi për përmbushjen inkasimit do të bëhet çdo tre muaj, për të reflektuar inkasimin e grumbulluar të të hyrave të KEK ShA-së në shtator dhe Dhjetor të vitit 2006. Megjithatë, KOSTT ShA do të kërkoj shqyrtim mujor të përmbushjes së inkasimit për të monitoruar pasojat e mundshme për pagesën e bilancit të papaguar të Tarifës së Përkohshme. Çdo ndryshim në Tarifën e Përkohshme do të bëhet në muajin që vjen pas mbarimit të tremujorit.

KEK ShA – KOSTT ShA ka përfunduar me 1 janar 2007. Megjithatë, ZRRE-ja konsideron që mund të vazhdoj të ofroj baza për aranzhim të pagesës së përkohshme në mes të KEK ShA (Furnizimit) dhe KOSTT ShA deri me datën e hyrjes në fuqi të pagesës së TUOS së re të aprovuar. Posaçërisht, pagesat nën këto aranzhime janë të lejuara për KEK ShA sipas tarifës me pakicë që është aktualisht.

Prandaj aranzhimet e përkohshme për pagesë të aprovuara nga ZRRE-ja janë, si në vazhdim:

1. KEK ShA do ti paguaj KOSTT ShA shumen prej €510,000 (të kalkuluar si €3.57 milion të ndarë në 7 muaj) secilin muaj deri sa të hyj në fuqi pagesa e re e TUOS-ë.

Me hyrjen në fuqi të pagesave të TUOS të ndarë pjesërisht në muaj, shumata që duhet paguhet sipas kësaj marrëveshje të përkohshme do të kalkulohet në baza pro-rata.